



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 21.03.2025
Numër Protokolli: 1907/2025

A.nr.113/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari–anëtarë, me Çlirim Zeka–në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.113/2025 të datës 16.01.2025 të parashtruar nga ankuesi M.B, kundër vendimit për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me numër Nr.47/2024 të datës 23.12.2024, në çështjen juridike “*Transferim*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.03.2025, mori:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.113/2025 e datës 16.01.2025 e parashtruar nga ankuesi M.B.

II. Anulohet Vendimi Nr.47/2024 i datës 23.12.2024 i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës dhe **Anulohet** numri rendor 40 i Raportit të Ristrukturimit të datës 02.12.2024 që ndërlidhet me Risistemimin për Pozitat e Shuara dhe Transferet në lidhje me pozitën e ankuesit “*Zyrtar i Shërbimit të Procesimit*” në zyrën regjionale Mitrovicë, ndërsa lënda kthehet **në rishqyrtim** dhe **rivendosije** te organi i njëjtë (Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës) vetëm për rastin e ankuesit.

III. Obligohet Komisioni i Ristrukturimit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në pikën **II** të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi M.B (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 16.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 204/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me numër Nr.47/2024 të datës 23.12.2024 të Divizionit të Burimeve Njerëzore, me pretendimin ankimor për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke më sistemuar nga pozita Zyrtar i Shërbimit të procesimit në pozitën Zyrtar i notifikimit në zyrën Regjionale në Mitrovicë, organi i lartcekur e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike e cila nuk konsiston në faktin se pozita në të cilën jam kategorizuar nuk përbën ndryshim dhe ngitje të kategorisë profesionale në të cilën aktualisht jam gjegjësisht kategorinë profesional 2, ashtu që nuk përkon fare me përvojën time të punës afro 30 vjeçare respektivisht 24 vite në AKKVP përgatitjen time profesionale dhe akademike ngase sipas përvojës do të duhej të ishte profesional 1, kjo duke u bazuar në Rregulloren QRK Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil nenin 13 paragrafi 7, pozicioni i ri që më është caktuar nuk përbën ndryshim dhe nuk përputhet me përgatitjen time profesionale, dhe se Divizioni i Burimeve Njerëzore nuk ka marrë parasysh asnjë nga kriteret e përcaktuara me Rregulloren QRK Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, kërkon ti aprovohet ankesa si e bazuar dhe të ndryshohet vendimi i Divizionit të Burimeve Njerëzore ashtu që nga pozita aktuale të kategorizohet në pajtim me përgatitjen profesionale dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.02.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, ndërsa Këshilli më datë 24.02.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 27.02.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 204/2025 të datës 16.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me numër Nr.47/2024 të datës 23.12.2024; Kërkesë për

rishqyrtim e M.B. drejtuar Burimeve Njerëzore në AKKVP i datës 27.12.2024; E-mail nga S.A. për M.B. etj. i datës 30.12.2024; E-mail nga M.B. për B.C. i datës 27.12.2024; E-mail nga B.C. për M.B. i datës 23.12.2024; Akt Emërim i M.B. i datës 06.01.2025; Dëshmi pune e lëshuar nga udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në AKKVP për M.B. i datës 19.01.2024; Ndryshim dhe plotësim i Akt Emërimit i M.B. i datës 15.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i M.B. i datës 29.01.2024; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i M.B. i datës 21.01.2023; Diplomë nga Kolegji Biznesi Prishtinë për M.B. me numër nr.54/15 i datës 19.02.2015; Diplomë nga Kolegji Biznesi Prishtinë për M.B. me numër nr.37/17 i datës 29.07.2017; Certifikatë nga SSHP për M.B. i datës 18.12.2023; Certifikatë nga Kryqi i kuq i Kosovës për M.B. i datës 21.10.2023; Certifikatë nga GFS për M.B. i datës 10.06.2018; Certifikatë nga eck për M.B. i datës 29.09.2019; Certifikatë nga Ikap për M.B. e muajit Prill 2022; Certifikatë nga AUK për M.B. i datës 13.12.2012; Certifikatë nga Ikap për M.B. e muajit Nëntor 2008; Certifikatë nga UBT për M.B. i datës 15.07.2008; Certifikatë nga unmik për M.B. i datës 07.06.2002; Letërnjoftim i M.B.; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 14.02.2025; Përgjigje në ankesë i datës 24.02.2025; Përshkrimi i punës për pozitën Zyrtar i Shërbimit të procesimit; Akt Emërim i M.B. i datës 01.01.2012; Rekomandimet e Komisionit të Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me referencë 01809/2024 i datës 02.12.2024; Formulari i përshkrimit të punës për pozitën Zyrtar i Notifikimit në AKKVP; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i M.B. i datës 25.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike i M.B. i datës 29.12.2021; shkresë me nr. protokolli 00243/14 e datës 08.04.2014; Përgjigje e Agjencisë Kosovare të Pronës me numër Ref.nr.00243/14 i datës 16.04.2014; Vendim i KPMSHCK me numër protokolli 1743/2014 i datës 18.06.2014; Ndryshim dhe plotësim i Akt Emërimit i M.B. i datës 08.07.2014; Ndryshim dhe plotësim i Akt Emërimit i M.B. i datës 14.08.2018; Ndryshim dhe plotësim i Akt Emërimit i M.B. i datës 02.07.2019; Certifikatë nga Kolegji Biznesi për M.B. i datës 03.11.2014; E-mail nga M.B. për B.C. i datës 27.12.2024; Vendim për shtyrje të afatit i KPMSHCK me numër protokolli 1310/2025 i datës 27.02.2025;

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e provave që gjenden në shkresat e lëndës , konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në **ri-shqyrtim** dhe **rivendosje** tek organi i njëjtë (Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës), **sepse**:

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht sipas Ndryshim dhe plotësimit të Akt Emërimit të datës 15.01.2021, rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës “Zyrtar i Shërbimit të Procesimit” në zyrën regjionale Mitrovicë në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Ndërsa sipas vendimit për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me numër Nr.47/2024 të datës 23.12.2024, ankuesi nga pozita aktuale “Zyrtar i Shërbimit të

Procesimit” transferohet në pozitën ‘*Zyrtar i Notifikimit*’ në kuadër të zyrës regjionale në Mitrovicë Departamenti për Koordinim Regjional në kuadër të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Nga shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës ka nxjerrë Rregulloren Nr.01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Si rrjedhojë është emëruar Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me vendimin Nr.00561/2024 të datës 25.04.2024. Duke iu referuar Rregullores Nr.01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se pozita “*Zyrtar i Shërbimit të Procesimit*” të cilin ankuesi e ka mbajtur sipas Ndryshim dhe plotësimit të Akt Emërimit të datës 15.01.2021 është shuar, respektivisht e njëjta pozitë më nuk figuron në strukturën e re organizative të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Komisioni i Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, duke vepruar sipas dispozitave të aplikuara të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ka nxjerrë Rekomandimet e Komisionit të Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me referencë 01809/2024 të datës 02.12.2024, përmes të cilit e ka përfunduar procesin e ristrukturimit duke iu referuara gjendjes faktike dhe efekteve juridike që ka krijuar hyrja në fuqi e rregullores së re për organizimin e brendshëm, respektivisht për pozitat të cilat janë shuar apo ndryshuar, titullarët që kanë mbajtur pozitat e shuara apo ndryshuara i janë nënshtruar procesit të transferimit, në këtë rast edhe ankuesi.

Sipas Rekomandimeve të Komisionit të Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me referencë 01809/2024 të datës 02.12.2024, numri rendor 40 përcaktohet edhe tabela e pozitave të cilat janë shuar në mesin e tyre edhe pozita e ankuesit “*Zyrtar i Shërbimit të Procesimit*” në zyrën regjionale Mitrovicë në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Përveç, tjerash Kolegji i Këshillit konstatoi se Komisioni i Ristrukturimit në raportin në fjalë, me rastin e propozimit që ankuesi të transferohet në pozitën përkatëse ‘*Zyrtar i Notifikimit*’ në kuadër të zyrës regjionale në Mitrovicë Departamenti për Koordinim Regjional në kuadër të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës nuk përputhet me përgatitjen profesionale të ankuesit.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së veprimeve të Komisionit të Ristrukturimit analizoi përshkrimin e punës për pozitën ‘*Zyrtar i Notifikimit*’ në kuadër të zyrës regjionale në Mitrovicë Departamenti për Koordinim Regjional në kuadër të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës ku në pikën e XII tek Kërkesat e përgjithshme formale dhe specifike përcaktohet kategoria dhe klasa e pozitës profesionale 2, grupi dhe fusha e kërkuar e arsimit G12/Grupi i shkencave shoqërore. Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë Bachelor. Drejtimi Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca

Politike, Psikologji, Punës Sociale, Gjeografi dhe Administratë Publike. Ndërsa bazuar në shkresat e lëndës të dërguara nga organi i punësimit ankuesi posedon Diplomë të lëshuar nga Kolegji Biznesi Prishtinë me numër nr.54/15 të datës 19.02.2015 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore universitare me datë 03.11.2014 dhe ka marrë gradën Menaxhimi i Emergjencave. Posedon Diplomë të lëshuar nga Kolegji Biznesi Prishtinë me numër nr.37/17 të datës 29.07.2017 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet pasdiplomike me datë 28.07.2017 dhe ka marrë gradën Master i Arteve në Menaxhimin e Emergjencave.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së veprimeve të Komisionit të Ristrukturimit, analizoi dispozitat e nenit 13 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 nën paragrafin 7.1, 7.2, 7.3, 7.4 dhe 8 të Rregullore Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: *1. Në rastet e shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, DMZP për institucionet e administratës shtetërore, apo NjMBNj për institucionet e tjera, brenda 30 ditëve nga miratimi i aktit të ristrukturimit krijon një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, për të cilën ky i fundit i plotëson kërkesat e vendit të punës. 8 / 9 2. Komisioni udhëhiqet nga përfaqësuesi i DMZP-së për institucionet e administratës shtetërore dhe nga përfaqësuesi i NjMBNj-së për institucionet e tjera. 3. Komisioni i Ristrukturimit përbëhet edhe nga dy anëtarë tjerë, të cilët janë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në paragrafin 3 të nenit 12 të kësaj Rregulloreje, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës. 4. Komisioni, brenda dyzetepesë (45) ditëve nga data e themelimit, i propozon me shkrim DMZP-së për institucionet e administratës shtetërore, apo NJMBNJ-së për institucionet e tjera, transferimin e nëpunësit siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 12 të kësaj Rregulloreje. 5. Komisioni në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit mbështetet në përshkrimet e vendeve të lira apo të atyre të krijuara të punës dhe kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve. 6. Vendimi është individual për çdo nëpunës. 7. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kritere: **7.1. përvojën e nëpunësit në shërbimin civil; 7.2. mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë të nëpunësit për tre (3) vitet e fundit; 7.3. kualifikimet profesionale të nëpunësit; dhe 7.4. trajnimet e nëpunësit.** 8. Komisioni i ristrukturimit cakton peshën specifike të kritereve të përcaktuara në paragrafin 7 të këtij neni dhe metodologjinë e vlerësimit të secilit kriter. Kolegji i Këshillit ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara pasi kualifikimet profesionale të nëpunësit nuk përputhen me pozitën të cilën është caktuar. Andaj, duke u nisur sipas përcaktimeve të dhëna si më lartë, Kolegji i Këshillit meqenëse është lëshuar vetëm në një pikë të shqyrtimit të ligjshmërisë së Rekomandimit të Komisionit të Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me referencë 01809/2024 të datës 02.12.2024, respektivisht në numrin rendor 40, ku përcaktohet edhe tabela e pozitave të cilat janë shuar në mesin e tyre edhe pozita e ankuesit “Zyrtar i Shërbimit të Procesimit”, konstatoi se Komisioni i Ristrukturimit në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 ku përcaktohet se: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material” dhe mbi këtë bazë*

konstatoi se në numrin rendor 40 Risistemimi për pozitat e shuara dhe transferet, në tabelën e pozitave të cilat janë shuar në mesin e tyre është edhe pozita e ankuesit “Zyrtar i Shërbimit të Procesimit”, e renditur në numrin rendor 40, të Raportit të Ristrukturimit me nr.01809/24 të datës 02.12.2024 , është në kundërshtim me ligjin material për arsyet e dhëna si më lartë, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit vendosi që lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje te Komisioni i Ristrukturimit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, ashtu që Komisioni i Ristrukturimit pas rishqyrtimit të lëndës së ankuesit duke marrë për bazë pikëpamjet juridike të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi duhet ta plotësojë/ndryshojë Raportin e Ristrukturimit të datës 02.12.2024, ashtu që në pajtim me dispozitat e nenit 13 paragrafi 5, 7 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: “5. Komisioni në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit mbështetet në përshkrimet e vendeve të lira apo të atyre të krijuara të punës dhe kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve” 7. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kritere: 7.1. përvojën e nëpunësit në shërbimin civil; 7.2. mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë të nëpunësit për tre (3) vitet e fundit; 7.3. kualifikimet profesionale të nëpunësit; dhe 7.4. trajnimet e nëpunësit, të propozojë që ankuesi të transferohet në njërën nga pozitat e lira për të cilat pozita i plotëson kriteret në kuadër të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës pozitë e cila është ekuivalente me pozitën që ka mbajtur ankuesi dhe që për të cilën rast u përcaktua si në arsyetimin e këtij vendim se pozita që ka mbajtur ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 15.01.2021 hynë në kuadër të kategorisë profesional 2.

Andaj si rrjedhojë duke marrë për bazë dispozitat e nenit 13 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ku Divizioni i Burimeve Njerëzore përmes Vendimit të datës 23.12.2024 me numër Nr.47/2024 e ka transferuar ankuesin në pozitën ‘Zyrtar i Notifikimit’ në kuadër të zyrës regjionale në Mitrovicë Departamenti për Koordinim Regjional në kuadër të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës është akt i paligjshëm pasi që është mbështetur mbi Rekomandimet e Komisionit të Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës të datës 02.12.2024, ashtu që pika përmes të cilës është propozuar transferi i ankuesit është konstatuar se është në kundërshtim me ligjin material dhe si rrjedhojë duke u mbështet në dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që Vendimi i datës 23.12.2024 me numër Nr.47/2024 të shfuqizohet sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa Divizioni i Burimeve Njerëzore duhet të nxjerr vendim të ri për transferimin e ankuesit në pozitën të cilën do të propozojë Komisioni i Ristrukturimit pas plotësimit të ndryshimit të Rekomandimeve të Komisionit të Ristrukturimit të datës 02.12.2024 sipas pikëpamjeve juridike të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.113/2025, datë 21/03/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit M.B;
- Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (Drejtorit Ekzekutiv dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore);
- Komisionit të Ristrukturimit si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.